



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
**Izborni Panel za Žalbe i Predstavke**

**A nr. 752/2013**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtaret Xhevdet Abazi kryesues, Muharrem Shala, dhe Muhamet Rexha anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Ganimete Qeriqi, kandidat për anëtarë të kuvendit komunalë në Lipjan nga koalicioni Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës dhe Lidhja Demokratike e Dardanisë (AAK-LDD), paraqitur kundër publikimit të raportit preliminar të shpallur nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) për shkak të mungesës së votave për zgjedhjet lokale të datës 03 Nëntorit 2013, në seancën e panelit të mbajtur me 08.11.2013, mori këtë:

## **V E N D I M**

**HIDHET** si e palejueshme ankesa e Ganimete Qeriqi, kandidat për anëtarë të kuvendit komunalë në Lipjan nga koalicioni AAK-LDD

### **Arsyetim**

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 07.11.2013, nga Ganimete Qeriqi, kandidat për anëtarë të kuvendit komunalë në Lipjan nga koalicioni AAK-LDD, në të cilën pretendohet se rezultati i kumtuar nga KQZ-ja nuk është real në këto qendra të votimit si më poshtë: Magure 1302 Janjevë 1303 Shalë 1304 Krajshte 1305 Gadime 1307 Rubovc 1320 Dobrajë 1322 Rufc 1324 Qv 1326 dhe Tashiqan 1331

PZAP-i, shqyrtoi lejueshmërinë e ankesës, gjeti se:

### **Ankesa është e palejuar**

PZAP-i, konstatoi se ankesa është e palejuar ngase rezultatit preliminarë i shpallur nga KQZ-ja nuk është përfundimtar dhe mund të ndryshoj në çdo moment dhe po ashtu ankesa në fjalë për rezultat preliminar në vendvotim është dashtë të parashtrahet në PZAP nga anëtarët e komisionit të vendvotimit sipas nenit 102.1 të LZP-së parasheh se “Çdo anëtarë i komisionit të Vendvotimit që ka vërejtje në rezultatet e shënuara në një vendvotim mund të regjistroj mospajtimin tij në librin e votimeve të vendvotimit dhe

*mund të dërgoj një vërejtje te Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës në përputhje me këtë ligj*". Në rastin konkret ankesa është parashtruar nga kandidati për anëtarë të kuvendit komunal që nuk është person i autorizuar sipas ligjit të parashtrës ankesë sipas dispozitës së lartcekur.

Bazuar në arsyet e sipërshënuar dhe në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së i cili parasheh se "PZAP-i, pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk i përmbushin standardet" dhe nenit 4.2 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, në të cilin përcaktohet se: "PZAP-i, mund të hidh poshtë (si të palejuar, të parregullta apo të pa afatshme) ankesat, të cilat nuk i plotësojnë kriteret e parapara në nenin 3 të këtyre rregullave dhe procedurave, po ashtu PZAP refuzon ankesat të cilat janë të pabazuara, apo të cilat janë në përputhje me dispozitat e duhura ligjore", vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës**

A nr. 752/2013 më datën 08.11.2013



**Kryesuesi i Panelit  
Xhevdet Abazi**

**Këshillë juridike:** PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.